



REPUBLIKA E SHQIPERISE

KUVENDI

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë

PROCESVERBAL

Tiranë, më 04.06.2018, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Petrit Vasili – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve të datave 28 dhe 30 maj 2018.
2. Bazuar në nenin 36, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, komisioni zhvillon seancë dëgjimore për zbatimin e ligjit “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”.

Marrin pjesë:

Petrit Vasili, Elisa Spiropali, Klodiana Spahiu, Ilir Pendavinji, Flamur Golemi, Edlira Bode, Arben Kamami, Roland Xhelilaj, Nuri Belba, Floida Kërpaçi dhe Nora Malaj.

Mungojnë:

Bardh Spahia, Adelina Rista, Almira Xhembulla, Vangjel Tavo, Halim Kosova, Orjola Pampuri, Grida Shqina dhe Lindita Metaliaj.

Të ftuar:

Frosina Gjino - Drejtore Ekzekutive e AOSHC (*Albanian Occupational Safety and Health Center*)

Kol Nikolla - President i Konfederatës së Sindikatave të Shqipërisë

Taf Koleci - Sekretar i Përgjithshëm i Federatës Sindikale të Punonjësve të Industrisë së Shqipërisë.

Sami Kariqi – Zëvendës-president i Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë

Hyqmet Melasi – përfaqësues BSPSH

Agim Lami - përfaqësues BSPSH

Mira Rakacolli- Zëvendësministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Antoneta Njehrrëna - Drejtore Juridike në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Eralda Marjani - përgjegjëse sektori në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes
Sociale

Genc Byrazeri - nëndrejtor i Institutit të Shëndetit Publik

Hajdar Luka - specialist i ISHP

Viktor Hysenllari – përfaqësues i Inspektoratit Qendror të Punës

Alma Prendi – përfaqësuese e Inspektoratit Qendror të Punës

Silva Banushi – Drejtoreshë në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave

Irida Qosja – Drejtoreshë në sektorin e Inspektimit të Marrëdhënieve të Punës, në
Inspektoriatin e Punës

Eda Beqiraj - specialiste në Inspektoriatin e Punës

HAPET MBLEDHJA

Petrit Vasili – Fillojmë mbledhjen e komisionit.

Në rendin e ditës komisioni, me mirëkuptim të plotë të anëtarëve të tij, kishte parashikuar një dëgjese për sigurinë dhe shëndetin në punë, funksionimin në praktikë, si dhe zbatimin e ligjit përkatës për këtë çështje. Pra, me fjalë të thjeshta, komisioni është shumë i interesuar që të ndajmë se cilat janë prokupacionet më të mëdha lidhur me sigurinë dhe shëndetin në punë. Kjo çështje është shumë delikate edhe nga pikëpamja shëndetësore, por edhe nga pikëpamja shoqërore për shkak të pasojave që një shëndet i cenuar në punë prodhon. Njëkohësisht, interes të madh ka edhe për nevojat dhe reflektimet përkatëse që lidhen jo vetëm me ndryshimet ligjore eventuale, por edhe me tërheqjen e vëmendjes së institucioneve të caktuara, të cilat duhet të ishin argumente për çështje që eventualisht do të dilnin nga dëgjesa, për t'ua adresuar me shumë forcë të gjitha institucioneve përkatëse, qofshin këto shtetërore apo private, pasi kjo çështje nuk lidhet vetëm me institucionet shtetërore, por edhe me ato private. Sigurisht që më fort është e lidhur me institucionet shtetërore, me monitorimin dhe ndjekjen e zbatimit të ligjshmërisë në praktikë. Kështu që kjo është një marrëdhënie e ndërsjelltë, e rëndësishme, por edhe e komplikuar.

Sot na nderojnë me pjesëmarrjen e tyre në komision: Frosina Gjino, nga Qendra Shqiptare e Sigurisë e Shëndetit në Punë; Kol Nikollaj dhe Taf Koleci nga Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë; Sami Kariqi, Hyqmet Melasi dhe Agim Lami nga Bashkimit i Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë; Mira Rakacolli, Merita Xhafaj dhe Antoneta Njehrrëna nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale; Genc Byrazeri dhe Hajdar Luka nga Instituti i Shëndetit Publik; Viktor Hysenllari dhe Alma Prendi nga Inspektoratit Qendror i Punës; Silva Banushi, Irida Qosja dhe Eda Beqiraj nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave.

I falënderoj të ftuarit për pjesëmarrjen, për kohën dhe gatishmërinë për t'iu përgjigjur ftesës sonë!

Meqenëse jemi në një moment të veçantë lidhur me përshtatjen jo vetëm të legjislacionit, por edhe të të gjitha problematikave përkatëse, unë dua ta filloj mbledhjen me një paraqitje shumë të shkurtër, në mënyrë të veçantë me dy-tri kritere themelore, të cilat janë shqetësim edhe në nivel evropian.

Për hapjen e diskutimit për këtë çështje, fjalën ia jap zonjës Frosina Gjino, pastaj në diskutimet e tjera që do të bëhen, duhet të kemi parasysh jo vetëm zbatimin e ligjit shqiptar,

por edhe ekzigjencat që vijnë, që procesi i integrimit europian bën lidhur me çështjet e shëndetit në punë dhe përshtatshmërisë së tij me direktivat europiane kanë për këtë çështje.

Zoti Pendavinji ka diçka për të shtuar.

Ilir Pendavinji- Zoti kryetar, meqenëse ka shumë të ftuar në mbledhje, ju sugjeroj që të vini një limit kohor, që secili të flasë. Duhet ta kemi të limituar kohën, sepse do të ketë diskutime dhe mbledhja do të zgjatet shumë.

Faleminderit!

Petrit Vasili- Faleminderit, zoti Pendavinji!

Ju lutem kontrollojeni vetë kohën, nuk dua që t'ju kërkoj unë ta ndërprisni fjalën, sepse nuk është shumë komode për mua. Interesi ynë është që opinionet tuaja t'i kemi sa më të përmbledhura, në mënyrë që edhe stafi teknik të ketë lehtësi gjatë zbardhjes dhe adresimit të tyre.

Zonja Frosina, fjala për ju.

Frosina Gjino – Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë, të nderuar pjesëmarrës, të nderuar përfaqësues të institucioneve shtetërore, është kënaqësi të mblidhemi sot këtu dhe të diskutojmë për çështjen e mbrojtjes në punë të punëmarrësve, të sigurisë dhe shëndetit në punë, sepse është një temë shumë e ndjeshme.

Gjithsecili nga ne do të tronditej nëse fëmija, gruaja ose burri shkojnë në punë dhe familjarët një telefonatë dhe i thonë: “Djali juaj vdiq në punë”, “Vajza juaj u aksidentua”. A e kuptoni çfarë traume është kjo për gjithsecilin nga ne?! Prandaj këto çështje duhet t'i shikojmë si çështje tonat të zemrës.

Unë jam koordinatore për Shqipërinë, për çështjet e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo zyrë financohet nga Komisioni Europian. Ne punojmë në nivel europian dhe zyrat qendrore i kemi në Shkup, Maqedoni, kështu që ne sjellim këtu edhe eksperiencën e rajonit. Ne, krahasuar me vendet e rajonit, kemi një lloj difference, por qëllimi i zyrës tonë dhe i kësaj dëgjese nuk është që të fillojmë të luftojmë, por të sjellim eksperiencën europiane, çfarë kemi dhe çfarë duhet të bëjmë. Unë mendoj se çështjet e sigurisë dhe shëndetit në punë në Shqipëri duhet të shihen në tri aspekte.

Aspekti i parë është përfshirja e punëmarrësve në çështjet e sigurisë dhe shëndetit në punë. Ne konstatojmë që në Shqipëri në kompanitë me mbi 50 punëmarrës janë ngritur këshillat e sigurisë dhe shëndetit në punë, por që shumë prej tyre funksionojnë formalisht. Unë kam marrë pjesë në një cikël të gjerë trajnimesh nëpër kompani dhe, kur i pyet punonjësit se kë kanë votuar si përfaqësuesin e tyre, realisht ata nuk e dinë, domethënë ekzistojnë formalisht. Prandaj

duhet që këta përfaqësues të punëmarrësve t'i fusim në një fazë tjetër, sepse edhe funksioni që ata do të kryejnë do të jetë ndryshe. Në ligj është definicion, që përfaqësuesit e punëmarrësve duhet të votohen nga punëmarrësit.

Gjatë zbatimit të ligjit ka pasur një boshllëk, i cili do kohën e vet që të plotësohet, por ne në Shqipëri nuk kemi ekspertë dhe kompani të sigurisë dhe shëndetit në punë. Në fakt, ekzistojnë disa kompani ndërkombëtare, ose që janë krijuar këtu, por nuk mjaftojnë. Në të gjithë rajonin ekspertët ose mjekët e sigurisë dhe shëndetit në punë përgatiten në universitete të veçanta, ku në fund diplomohen si inxhinierë të sigurisë dhe shëndetit në punë, por ne në Shqipëri nuk kemi as kurse trajnimi, jo më universitete. Prandaj duhet të ndërtohet një skemë e tillë dhe të plotësohet ky boshllëk ligjor, në mënyrë që të trajnohen ekspertët e sigurisë dhe shëndetit në punë dhe t'i nënshtrohen një provimi. Duhet të ekzistojë një institucion që t'i certifikojë këta ekspertë dhe këto kompani. Sipas mendimit tim, certifikimi i ekspertëve, ashtu siç e kanë edhe shumica e vendeve europiane, duhet të bëhet nga Inspektorati Shtetëror i Punës, sepse ky inspektorat luan rolin kryesor për sigurinë dhe shëndetin në punë.

Neve na mungon ndërgjegjësimi i punëmarrësve. Duhet të ekzistojnë skema kombëtare për të realizuar këtë ndërgjegjësim. Mosndërgjegjësimi i punëmarrësit vjen, sepse ata nuk i njohin ligjet dhe të drejtat e tyre. Sigurisht që një punëtor, i cili punon në ndërtim dhe nuk është i kualifikuar, nuk ka pse të njohë të gjithë legjislacionin. Prandaj një detyrë e rëndësishme këtu i takon shoqërisë civile dhe sindikatave, krahas institucioneve shtetërore, që të ndërgjegjësojnë. Roli i medias është shumë i madh dhe i padiskutueshëm. Media nuk duhet të merret vetëm me njoftime, si "U vra filani; u sëmur tjetri". Jam dakord që të bëhen njoftime, por media duhet të organizojë më shumë tryeza të rrumbullakëta, të ftojë ekspertë, në mënyrë që këto çështje të trajtohen dhe njerëzit të marrin vesh që në kontratat e tyre të punës nuk kanë vetëm detyra. Këto ishin shkurtimisht mendimet e mia.

Ju faleminderit!

Petrit Vasili – Ju faleminderit për parashtresën, për prezantimin shumë të përmbledhur dhe për praninë tuaj këtu!

Sipas radhës, ftoj të marrë fjalën zotin Kolë Nikolla, president i Konfederatës së Sindikatave të Shqipërisë. Të gjithë kolegët kanë përpara edhe një material shumë të mirë të përmbledhur lidhur me disa problematika kryesore.

Zoti Nikollaj, faleminderit edhe për materialin që i keni paraqitur komisionit, pasi e lehtëson shumë adresimin e çështjeve!

Keni fjalën për të shprehur çdo gjë tjetër, të cilën doni ta nënvizoni edhe më fort.

Kol Nikollaj – Së pari, dua t’ju falënderoj ju për këtë tryezë, e cila besoj se është në vazhden e aktiviteteve të 28 prillit, Ditës Botërore të Sigurisë së Shëndetit në Punë, pavarësisht se kalendari është spostuar për shkak të politikës. Sigurisht, nuk jemi shumë të lumtur që komisioni nuk është i kompozuar nga të gjitha krahët politike, por besoj se ne, sindikatat, duke pasur në fokus gjithmonë rolin tonë si kritizerë dhe opozitarë, do t’i plotësojmë këto mangësi. Normalisht, edhe materiali që keni përpara, por edhe këto që do të them unë janë pjesë e mosrealizimeve të ligjit. Nuk duam të jemi nihilistë, por ne nuk jemi ndaluar tek aspektet pozitive, sepse besoj se sot nuk jemi për të propaganduar përvojën pozitive, por të parë shkaqet, të metat dhe dobësitë gjatë zbatimit të ligjit.

Siguria dhe shëndeti në punë garantohet ligjërisht nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në kreun IV të saj “Të drejtat dhe liritë ekonomike, sociale dhe kulturore”, nga konventa nr. 155 e ILO-s “Për sigurinë në punë, shëndetin dhe mjedisin e punës” së bashku me protokollin e saj të vitit 2002, nga Kodi i Punës, kreu VIII, nenet 39-75, dhe nga ligji nr. 10237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, që është ligji themelor. Pavarësisht këtij ansambli të kompletuar ligjor, situata vazhdon të mos jetë e kontrolluar mire, duke mos pasur standardet e kërkuara.

Karta Sociale Europiane e rishikuar, si një dokument themelor, e nënshkruar edhe nga vendi ynë, përcakton të drejtën për kushte pune të sigurt dhe të shëndetshme. Ky dokument u garanton shqiptarëve, veçanërisht punëtorëve shqiptarë, të drejtën për të qenë pjesëmarrës në përcaktimin e kushteve të punës dhe mjedisit në punë. Realiteti flet ndryshe. Punëtorëve shqiptarë nuk u garantohet një ushtrim efektiv i të drejtës për kushte të sigurt dhe të shëndetshme në punë. Është e vërtetë që ligji nr. 10237 i vitit 2010 ka një fushë të gjerë zbatimi dhe përfshin punëmarrësit e të gjithë sektorëve dhe institucioneve në kuptimin e drejtpërdrejtë të fjalës punëmarrës, duke përfshirë edhe personelin civil që ka marrëdhënie pune të karakterit administrativ, por njohja dhe zbatimi i tij vazhdon të jetë në kufijtë minimalë, pavarësisht se ka 8 vjet që është miratuar. Ky ligj ka karakter informues, parandalues dhe ndëshkues, por asnjëra nga këto kolona nuk është konsoliduar. Këto kolona të ligjit vazhdojnë të mbeten të paharmonizuara ndërmjet tyre. Ligji i detyron punëdhënësit të vlerësojnë rrezikun që vjen nga ushtrimi i aktivitetit të ndërmarrjes së tij. Aktualisht kjo mund të ndodhë në fillim të aktiviteti të ndërmarrjes, pastaj harrohet dhe anashkalohet qëllimisht.

Ende nuk bëhet fjalë për kontrollin e efektivitetit të këtyre masave parandaluese, të cilat duhet ta bëjnë punëdhënësin dhe strukturat shtetërore përgjegjëse për sigurinë dhe shëndetin në punë. Ligji përcakton ngritjen dhe funksionimin e shërbimeve mbrojtëse dhe parandaluese në ndërmarrje, siç është Këshilli i Sigurisë së Shëndetit në Punë. Të gjithë jemi

dëshmitarë të moszbatimit të këtij detyrimi ligjor. Ky tashmë është kthyer në formalitet. Madje, edhe aty ku ka pasur disa përpjekje të ILO-së e të sindikatave, lëshimet reciproke të punëdhënësve dhe të qeverisë ndaj njëri-tjetrit në kurriz të ligjit dhe mospërfshirja e sindikatave në aspektin informues dhe konsultues e bëjnë të pamundur zbatimin e këtij detyrimi ligjor. Kjo nuk mund të ndodhë kur ende nuk zbatohet kreu VII i ligjit që përcakton autoritetin shtetëror përgjegjës. Ky autoritet fillon nga Këshilli Ndërmnistror për Çështjet e Sigurisë së Shëndetit në Punë, i cili ngrihet dhe funksionon me urdhër të Kryeministrit. Madje, jo vetëm kaq, por Kryeministri duhet të përcaktojë edhe rregullat procedurale të këtij Këshilli, i cili do të jetë burim furnizimi me këshillime, ide dhe propozime konkrete për qeverinë dhe aktorët socialë. Ky Këshill duhet të vlerësojë dhe gjendjen e situatat aktuale apo të krijuara rishtaz dhe të nxjerrë rekomandime e propozime për ndryshimin e përmirësimin e saj.

Autoriteti Shtetëror përgjegjës për çështjet e sigurisë dhe shëndetit në punë, i cili në strukturën e re qeverisëse ka krijuar një konfuzion dhe mungesë strukturash të mirëfillta për realizimin e politikave, hartimin e dokumenteve, akteve normative, rregulloreve, monitorimin dhe realizimin e kontrollit, koordinimin me institucionet e varësisë apo ato bashkë përgjegjëse, si dhe bashkëpunimin me partnerët socialë etj.

Lë për të dëshiruar edhe situata e autoritetit përgjegjës për shëndetësinë, i cili nuk e ka zgjidhur ende problemin e mjekësisë së punës që mungon si profesion, por edhe si kurrikul shkollore universitare.

Ky autoritet nuk kushton kontrollin e duhur, konform ligjit, për shërbimet mjekësore që u jepen punëmarrësve në vendet e punës, si dhe nuk kontrollon gjendjen shëndetësore të punëmarrësve.

Pavarësisht se ligji ngarkon edhe autoritete të tjera përgjegjëse, si Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Energjetikës, Ministrinë e Infrastrukturës, Telekomunikacionit, Policinë, Shërbimin Informativ Kombëtar etj., të cilët duhet të angazhohen dhe të përfshihen në masat parandaluese, në hetimet administrative dhe në sanksionet ligjore. Këto institucione nuk bashkëpunojnë si duhet dhe nuk kanë hartuar apo bërë publike rregullat e posaçme, sipas fushës së tyre të veprimit.

Në funksion të zbatimit të këtij ligji (neni 44 i tij) ka dalë VKM-ja nr. 107, datë 09.02.2011 “Për përbërjen, rregullat e organizimit dhe të funksionit të Këshillit të Sigurisë dhe Shëndetit në punë dhe përfaqësuesit e punëmarrësve”. Këta këshilla nuk po e luajnë ende rolin e tyre. Ato zgjidhen formalisht nga punëdhënësi. Në asnjë rast nuk ndiqen procedurat e përzgjedhjes dhe votimit konform ligjit. Kjo vjen edhe për faktin se punëdhënësit dhe organizatat e punëdhënësve nuk janë të organizuara dhe nuk funksionojnë në nivel ndërmarrje,

sektori apo territori. Edhe aty ku këta këshilla janë ngritur formalisht, nuk funksionojnë sipas kësaj VKM-je, lëre pastaj të flitet për këshilla profesionale apo ndërprofesionale.

Megjithëse po kalojnë shtatë vjet nga miratimi i VKM-së nr. 108, datë 09.02.2011 “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe shëndetit në punë”, ajo mbetet në fillesat e zbatimit, madje në disa ndërmarrje a sektorë, këto dy vjetët e fundit ka bërë hapa mbrapa, si rezultat i paralizimit të strukturave kontrolluese e ligjzbatuese të punësimit e marrëdhënieve të punës.

Strukturat shtetërore përkatëse ende nuk kanë një databazë të të gjitha ndërmarrjeve të ndara në katër grupe sipas ligjit. Ligji e përcakton qartë: “Numri i punëmarrësve përgjegjës për çështjet e sigurisë dhe shëndetit në punë në ndërmarrje llogaritet duke pjesëtuar numrin e të punësuarve në ndërmarrje me numrin e ditëve të punës të punuara në një vit”. Në asnjë ndërmarrje nuk realizohet një gjë e tillë.

Po bëhen tetë vjet, por ende nuk është hartuar dhe publikuar regjistri kombëtar i “mjekëve të punës”, pa folur pastaj për urdhrin profesional të tyre, për trajnimin në vazhdimësi etj.

Nuk respektohet puna me kohë të plotë e mjekut të punës, kryesisht në ndërmarrjet me 50-250 punonjës, në sektorët në procese pune të vështira, si fabrika, uzina, miniera, porte etj. Edhe në fasoneri, në ndërmarrjet me mbi 250 punonjës të punësuar, kemi mungesë të “mjekut të punës” me kohë të plotë. Pothuajse në të gjitha ndërmarrjet mungojnë kartelat e shëndetit të punonjësve, qoftë për vizitën e parë kur merren në punë, qoftë për vizitat periodike që ligji detyron të kryhen.

Ligji ngarkon ministrinë përgjegjëse për çështjet e sigurisë dhe shëndetit në punë që të nxjerrë udhëzime të veçanta për subjektet publike dhe private, për detyrimet e veçanta të punëdhënësit ndaj ligjit, por ky veprim nuk po kryhet ende.

Ligji ngarkon për regjistrimin e aksidenteve në punë Inspektoratin Shtetëror të Punës dhe Institutin e Sigurimeve Shoqërore, të cilët ende nuk kanë përgatitur një regjistër kombëtar të aksidenteve në punë, ku të përfshihen edhe aksidentet në sektorin informal.

Që nga viti 2010, kur u miratua ligji, e deri në vitin 2013, janë miratuar vetëm gjashtë akte nënligjore në zbatim të tij. Gjatë vitit 2014 janë miratuar edhe pesë akte të tjera, kohë kur ministër Pune ishte zoti Veliaj. Neni 44 i ligjit ngarkon institucionet që, brenda gjashtë muajve, të bënin kompletimin me akte nënligjore, me urdhëresa e rregullore, veprim i cili nuk është realizuar edhe sot.

Prandaj i kërkojmë këtij komisioni të nderuar t'i tërheqë vëmendjen qeverisë që t'i kthehet përsëri plotësimin të këtij ligji me akte nënligjore, me rregullore, me modelet dhe praktikatat më të mira të zbatimit të tij.

Në përfundim, dua të theksoj se zbatimi i këtij ligji, ashtu si edhe shumë ligje të tjera, që kanë objekt marrëdhëniet e punës dhe të partneritetit social, do të kenë vështirësi në zbatim, për aq kohë sa vendi ynë vazhdon të mbetet i vetmi vend pa një ligj të veçantë specifik për organizimin dhe funksionimin e aktivitetit sindikal të punëdhënësve dhe punëmarrësve në Shqipëri, si dhe një ligj për kontraktimin kolektiv dhe për zgjidhjen paqësore të konflikteve kolektive të punës.

Së fundi, nuk mund të zbatohet ligji i “Sigurisë dhe shëndetit në punë” pa reformuar në mënyrë profesionale dhe pa përforcuar kapacitetet njerëzore infrastrukture të Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Përkujdesjes Shoqërore. Ky institucion, me një rëndësi të veçantë në fushën e inspektimit dhe parandalimit të hetimit të sigurisë dhe shëndetit në punë, aktualisht ka rreth 94 inspektorë dhe 3 automjete me të cilat duhet të kontrollojnë të gjitha ndërmarrjet e vendit tonë. Kjo është tërësisht e pamundur. Nga vërtetimet tona na rezulton se 2/3 e inspektorëve janë jashtë profilit, të patrajnuar, me arsim dhe njohuri të mangëta në këtë fushë.

Edhe një herë, duke ju falënderuar, ju garantoj të gjithë mbështetjen dhe bashkëpunimin konstruktiv të KSSH-së me qeverinë, me politikbërjen dhe vendimmarrjen për u përket fushave të sigurisë dhe shëndetit në punë!

Petrit Vasili – Faleminderit, zoti Nikolla!

Ne patëm një kërkesë të drejtpërdrejtë për 2-3 pikat kryesore të materialit, sepse materialin e kishim në dorë dhe na interesonte që të qëndronim në pika të veçanta, megjithatë edhe riparaqitja e tij është e mirëpritur. Ndonjë nga pjesëtarët e konfederatave që ju shoqërojnë, a ka ndonjë gjë për të shtuar? Në qoftë se nuk ka, faleminderit! Me dakordësinë e kolegëve, do të vazhdojmë me informacionin që duan të ndajnë me ne të ftuarit e tjerë, apo jeni dakord që të bëjmë ndonjë pyetje që në këtë moment, sepse materiali që është paraqitur nga konfederatat është shumë i gjerë dhe ka disa probleme.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Urdhëroni!

Ju lutem, prezantohuni!

Sami Kariqi – Unë jam zëvendëskryetar i Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë. Nuk dua të hyj në detaje, sepse një pjesë e konsiderueshme e gjërave u thanë nga parafolësit, por mendoj se e gjithë lëvizja e inspektorateve ka rënë për arsye se është shkruar Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale. Kjo ka sjellë hantikapin më të madh jo vetëm në

sigurimin dhe shëndetin në punë, por edhe në zyrat e pajtimit dhe zyra të tjera, të cilat funksiononin pranë Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale.

Për sa i përket zbatueshmërisë së ligjit, ne kemi një ligj, i cili është bërë nën monitorimin e Këshillit të Europës dhe Bashkimit European, datë 18 shkurt 2010, mendojmë se disa nga amendamentet shtesë të ligjit të ligjit, udhëzimet kanë dalë gjatë kohës që ka qenë Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale dhe tani jo vetëm janë stopuar, por as nuk funksionojnë. Pra, nuk është problemi se është stopuar, por kur do të fillojë funksionimi. Me këtë strukturë që është sot, pra një pjesë pranë Ministrisë së Financave dhe një pjesë tjetër pranë Ministrisë së Shëndetësisë, do të na krijojë një hantikap shumë të madh, i cili do ta diskriminojë punëmarrësin.

Për sa u përket këshillave të sigurimit dhe shëndetit në punë, ato veprojnë në mënyrë legjislativë vetëm në ato vendet ku janë kontratat kolektive të lidhura me sindikatat, kurse në pjesët e tjera janë vetëm emërime dhe jo funksionime, edhe në ato institucione që mendojmë.

Për sa i përket sigurimit të shëndetit në punë dhe inspektoratit, numri jo vetëm është i vogël (pra atë që tha parafolësi), por ne nuk kemi mjete lëvizëse. Ato mjete lëvizëse që janë, e kanë të limituar edhe karburantin që përdorin. Kur ne e dimë se Tirana është pjesa më e madhe e taksapaguesve shqiptarë, është pjesa më e madhe e bizneseve, pikërisht Tirana nuk funksionon dot, nuk merr dot vetëm rrugën e autostradës për shkak se nuk kemi para. Duke qenë pjesë e Ministrisë së Financave, ne menduam se ky buxhet do të zgjerohej.

Unë kisha një raport të gjatë, por nuk dua ta konsumoj edhe për arsye kohe, edhe se një pjesë e tyre u prek. Për sa i përket asaj që Reparti i Inspektim Shpëtimit të Minierave duhet të futet në inspektoratin e përgjithshëm, kjo nuk duhet pranuar në asnjë mënyrë. Në Francë dhe në Gjermani Repartin e Inspektim Shpëtimit të Minierave e kanë më vete. Argumenti bazë është se, përderisa pasojat me humbje jete 20%-21% janë nga punonjësit e nëntokës së minierave, atëherë inspektorati i RISHM-it duhet të jetë më vete, nuk duhet të bashkohet me inspektoratet e tjera, qoftë me atë të elektrikut, qoftë me atë të naftës, qoftë me atë të ndërtimit apo të tjera me radhë, që janë bashkë. Ju lutem shumë, kijeni parasysh vërejtjen tonë, sepse në inspektoratin e RISHM-it do të vijin njerëz, që nuk janë kompetentë për punën që do të kryejnë, aty janë punonjësit më të aftë dhe më të kualifikuar, qoftë në grupet inxhiniera-teknikë, qoftë në problemet e minierës në rastet e aksidenteve.

Së fundi, duke ju falënderuar për të gjitha, sepse nuk dua të mbaj referat të gjatë, mendoj se të gjitha ato që u thanë më parë janë dhe qëndrojnë. Nuk është se nuk është punuar, por edhe një herë, insistoј që shkrirja e Ministrisë së Punëve dhe Çështjeve Sociale ka sjellë pasoja tek të gjitha ndërmarrjet, të cilat nuk mund të ndiqen dot për arsye të shkrirjes së inspektorateve të

ndryshme në Ministrinë e Punës, apo zvogëlimi i masës së tyre. Ju lutem, kijeni parasysh që patjetër duhet një fond për inspektoratet e ndryshme, sepse ky fond është jo vetëm i pamjaftueshëm, por është aq i vogël sa nuk mund të bëhet asnjë kontroll, është minimizimi i kontrolleve dhe kjo nesër do të sjellë pasoja, të cilat do të jenë të pariparueshme për familjet tona.

Faleminderit!

Petrit Vasili – Faleminderit, zoti Kariqi!

Meqenëse një pjesë e rëndësishme e ekspozesë u nda gjerësisht dhe në mënyrë profesionale, unë nuk bëj kot, por për të hedhur më shumë dritë. Jemi në një moment, në të cilin ka një ligj, ku struktura e tij, pse jo piramidale, nuk është në lëvizje, pasi në material, me sa kuptohet, thuhet se këshillat ministrorë për çështjet e sigurisë së shëndetit në punë pothuajse nuk funksionojnë, përderisa thuhet se nuk janë përcaktuar as rregullat procedurale e të tjerë. Pra, një këshillë i cili nuk ka rregulla...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë e citoj materialin për të qenë gjithmonë sa më korrekt me citimet e mia.

Njëherazi probleme të mëdha ka edhe autoriteti përgjegjës për çështjet e sigurisë dhe shëndetit në punë.

Së treti, mungon kurrikula, pra niveli i formimit universitar, është një kurrikul që është tretur rrugës, pasi “mjekët e punës” kanë qenë mjekë, të cilët janë formuar shumë mirë para viteve ’90, unë jam një prej tyre dhe e di shumë mirë si funksiononte dhe çfarë kishte. Njëherazi në material thuhet se, sepse thashë që çështja e shëndetit është e para në radhë, pothuajse në të gjitha ndërmarrjet mungojnë kartelat e shëndetit të punonjësve, qoftë për vizitën e parë, qoftë për vizitat periodike. Pa kartelë të evidentimit të një punonjësi që hyn në punë dhe pa vizitat periodike, nuk ka as “mjekësi pune”, nuk ka nevojë të ketë as inspektorat pune dhe, praktikisht, situata e shëndetësore është jashtë kontrollit. Thelbi i “mjekësisë së punës” është ndjekja në dinamikë për të vlerësuar se cili është efekti i punës në shëndet dhe cilat janë elementet të caktuara në strukturën e organizmit të njeriut, të cilat reagojnë sipas profesioneve, të cilave ai u nënshtrohet dhe mbi bazë të tyre është edhe presioni që i bëhet punëdhënësit për të bërë modifikime atje ku duhet.

Po të vijmë në këtë pikë, ku diskutohet edhe mospasja e kartelave, jua them me shumë gjakftohtësi se të gjitha këto këshillat mund të ngrihen, por nuk hyjnë në punë për asgjë. “Mjekësia e punës” ka një rregull kokëfortë, ose ndiqet në mënyrë të vazhdueshme në terren, prandaj dhe “mjeku i punës” është një mjek që nuk u ndahet të sëmurëve të tij. Mjeku që ka kontaktin më të shpeshtë, nga të gjithë mjekët që punojnë në një praktikë mjekësore të rregullt,

me njerëzit e tij dhe me pacientët e tij është “mjeku i punës”. Mjeku i familjes i ka kontaktet në varësi të vizitave, kurse mjeku i punës i ka të përditshme si rregull, sepse kështu bëhet edhe kapja e simptomave të hershme. Duhet të dini se sëmundjet, që burojnë nga problemet e shëndetit në punë, në të gjithë klasifikimet që bëhen në botë zënë mbi 60% të shkaqeve të sëmundjeve, pra të sëmundjeve që lindin nga problematikat e punës, qoftë kjo punë e rëndë, qoftë punë mesatare, qoftë një punë, të cilën jemi mësuar ta quajmë punë zyre. Risqet e punës janë të shumëllojshme dhe në këtë pikë mendoj se inspektoratet, sigurisht, kanë shumë për të bërë, por në rast se e gjithë kjo infrastrukturë nuk imponohet të ngrihet, mund të thuhet me plot gojë se shëndeti apo problematikat e shëndetit në punë janë të gjitha ndjekje spontane, nuk janë as ndjekje shkencore, sepse ka kritere, protokolle shkencore çdo element i sëmundjeve profesionale. Termi “mjekësi pune”, që të merremi vesh, është një term kompromisi, që është gjetur në shkencë. Dikur është quajtur “mjekësi profesionale”, dikur “mjekësi e punës”, dikur janë futur nën ombrellën e madhe të higjienës së punës, që i kishte të gjitha degët brenda. Por, në fund të tij, elementi thelbësor ka qenë: ndjekja e vazhdueshme për t’u dalë përpara rreziqeve të mëdha që vijnë nga puna, duke filluar nga risqet kancerogjene deri te risqet e invaliditetit të lartë, ndërsa te gratë shkojnë deri tek infertiliteti. Këto janë shkaku i sëmundjeve kronike të mëdha, qoftë të grupit të madh të sëmundjeve të zemrës, që janë edhe shkaku themelor i vdekshmërisë, por edhe i sëmundjeve pulmonare. Pikërisht, kapja në kohë, madje në momente të caktuara largimi fare nga puna, në rast se është pothuajse e papajtueshme me atë ambient pune, janë mënyrat me të cilat veprohet sot në botë.

Që të jem i sinqertë, po në këtë komision e kam thënë dhe e përsëris, nuk kam asnjë rezervë, madje do ta them vazhdimisht: qeveria ka zgjidhjet e saj, është sovranë në atë punë, por Ministria e Punës, për nga mënyra si ishte organizuar, kishte një përqendrim më të fortë, më konkret në çështje të tilla. Sigurisht, fragmentimi ka problemet e tij. E dhëntë Zoti që të jemi në gabim, por e gjithë eksperiencia botërore tregon se përqendrimi në problematika të tilla të jep fuqinë. Nejse, kjo është një punë për t’u parë, por të paktën kam një pyetje për Ministrinë e Shëndetësisë, e cila mbulon edhe çështjet sociale: cila është mundësia e reflektimit, sepse këto konstatime janë të vërteta?

Pastaj lidhur me pyetjen: “Kur mund të ngrihet Këshilli Administrator për Çështjet e Sigurisë së Shëndetit në Punë?”, duhet të kishim ndonjë të ftuar nga Këshilli i Ministrave për ta dhënë përgjigjen, sepse kjo i takon një niveli tjetër, që del mbi ministrinë përkatëse.

Atëherë, a ka ndonjë koment për këto gjëra nga Ministria e Shëndetësisë? Materiali që Konfederata e Sindikatave ka paraqitur, është plotësuar edhe nga elemente të tjera, që zoti Karriqi solli, sigurisht do të vihet edhe në dispozicionin tuaj për më tutje, por nga njohja që

keni rreth problemit, cila mund të jetë qasja? Cilat mund të jenë zgjidhjet? Çfarë është projektuar, që të paktën, nga ana institucionale, të fillojë të vihet në lëvizje, se, në fund të fundit, ato institucione do ta bëjnë? Ndërsa ne marrim ndjeshmërinë dhe ia përcjellim qeverisë për ta pasur në tavolinën e punës.

Po, zonja Rakacolli.

Mira Rakacolli – Faleminderit!

I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar deputetë dhe të ftuar,

Natyrisht, unë e kisha përgatitur një material, por, siç u tha, anët pozitive do t'i anashkalojmë, pasi ka më tepër rëndësi të rregullojmë problemet që janë ngritur.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në vazhdimësi i ka parë me shumë vëmendje dhe precedencë të gjitha detyrimet që i ngarkon ligji i vitit 2010 kësaj ministrie dhe i ka plotësuar në vazhdimësi në vite të gjitha aktet nënligjore, që rrjedhin nga ky ligj, qoftë me vendim të Këshillit të Ministrave, qoftë me rregullore. Pra, janë të shkruara dhe të miratuara në Këshillin e Ministrave të gjitha rregulloret që kanë të bëjnë me mbrojtjen e shëndetit në punë, sepse siguria në punë është një fushë, që mbulohet edhe nga shumë aktorë të tjerë.

Rolin e saj Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, përveç strukturave që i ka të ngritura në ministri, e ushtron edhe nëpërmjet Institutit të Shëndetit Publik, sidomos rolin kontrollues të zbatimit të atyre rregulloreve e ushtron nëpërmjet Inspektoratit Shëndetësor. Ky Inspektorat e ushtron veprimtarinë e tij në të gjitha aktet nënligjore, që kanë të bëjnë me ligjet “Për kujdesin shëndetësor”, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, “Për inspektimin sanitar” dhe në të gjitha rregulloret, që kanë të bëjnë me aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat e shërbimeve të specializuara që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë, me kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës, si dhe me procedurat në llojin e testeve ekzaminuese mjekësore (ato që ju përmendët, zoti kryetar), që do të kryhen në varësi të punës që kryejnë punëmarrësit, si dhe në mënyrën e funksionimit të shërbimit mjekësor në punë.

Objekt i inspektimit, i përcaktuar mirë nga kjo ministri se çfarë duhet të bëjë ky Inspektorat, janë rreth 15 pika, si: kontrata e mjekut të ndërmarrjes, me kohë të plotë; leja e ushtrimit të profesionit të mjekut të ndërmarrjes; raporti mjeko-ligjor i punëmarrësit; kontrolli paraprak shëndetësor në momentin e punësimit apo gjatë tremujorit të parë; deklarata për pajtimin e gjendjes shëndetësore, në varësi të punës që do të kryejë punëmarrësi; raporti i kontrollit shëndetësor në punë, sipas një formati të përcaktuar; ekzaminimet e rregullta dhe periodike të punëmarrësve, sipas faktorëve të riskut në vendin e punës, si dhe shumë të tjera,

ku unë do të veçoja edhe ekzaminimet mjekësore profesionale shtesë, nëse kanë ndryshuar faktorët specifikë të riskut. Gjithashtu, shikohen librezat shëndetësore; kontratat për largimin e mbeturinave; raporti i analizës së ujit të pijshëm; uniformat e punonjësve; ajrimi i vendeve të mbyllura të punës; temperatura e mjedisit, ndriçimi natyral dhe artificial; akt-miratimi higjienosanitar; mjediset e veçanta me kushte të përshtatshme për nënat, të cilat kanë fëmijë në gji dhe punojnë; si dhe pajisja e subjektit me anekset hidrosanitare (me dushet, lavamanët) e të tjerë.

Tematika e shëndetit në punë programohet nga ky Inspektorat që të kryhet çdo vit. Sipas një raporti që kam sjellë këtu, vetëm gjatë periudhës shkurt-mars të vitit 2018 janë kryer 618 inspektime për të gjitha ato që unë citova dhe janë marrë vetëm tri masa administrative. Pra, shumica e këtyre inspektimeve ka rezultuar e plotësuar. Por është shumë i rëndësishëm problemi i cili u ngrit edhe nga zoti kryetar, edhe nga pjesëtarët e tjerë që kemi këtu, i zhvillimit të mjekësisë së punës ose sëmundjeve profesionale, që është vërtet një sfidë që nuk varet vetëm nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, por ka të bëjë edhe me kurrikulën e Universitetit të Mjekësisë, që ju e dini të gjithë se, në bazë të ligjit “Për arsimin e lartë”, është një institucion autonom.

Në lidhje me organizimin dhe funksionimin e mirë të mjekësisë së punës, kemi qenë pjesë e saj që në vitin kur ka ekzistuar Kabineti i Sëmundjeve Profesionale me të gjithë shërbimin, me shtretër të sëmundjeve profesionale, i cili në vitin 2005 mbeti vetëm si kabinet, për arsye të rikonstruktimit ose të rikompozimit të QSUT-së, kur u mbyll shërbimi me shtretër. Koha tregoi se ky nuk ishte një vendim i drejtë, por tani, përveç Kabinetit të Sëmundjeve Profesionale, që është i vendosur në ambientet e QSUT-së, në Repartin e Sëmundjeve Interne ka edhe një seksion të caktuar për shtrimin e të sëmurëve me sëmundje profesionale.

Në lidhje me kurrikulën, është e domosdoshme dhe ministrja e Shëndetësisë e ka shtruar me forcë përpara në organet përkatëse të Universitetit të Mjekësisë nevojën e përgatitjes së specialistëve të mirëfilltë të sëmundjeve profesionale. Ky është një proces, i cili vazhdon të mbetet në diskutim, sepse, siç e thashë, Universiteti është edhe autonom, por kemi arritur një gjë të tillë, që, përveç kurrikulës, përveç formimit që jepet për mjekun e përgjithshëm, kurrikula (formim për mjekësinë e punës dhe sëmundjet profesionale) është futur edhe te kurset e specializimit, pas insistimit të Ministrisë së Shëndetësisë.

Sivjet ajo është futur edhe në programin e specializimeve afatgjata të lëndëve të Pneumologjisë, të Neurologjisë, të Shëndetit Publik dhe për herë të parë, vendoset si një lëndë me kredite të mjaftueshme në vitin e tretë, në lëndët e Shëndetit Publik. Me programin që është bërë tani, do ta fillojnë ata studentë që do të jenë në vitin e tretë vitin e ardhshëm. Pra, arsimi

në lëndën e Mjekësisë së Punës shpresojmë të finalizohet, duke krijuar kurse të posaçme edhe në zbatim të VKM-së, që ka dalë në vitin 2016 që mjekët që merren me Mjekësinë e Punës, duhet të kenë kryer kurse të plota të specializimit, ndoshta edhe më afatshkurtra. Pra, ky është një proces që ne e kemi shumë në vëmendje.

Në drejtim të formimit të kulturës së punës, ka edhe disa lëndë që bëhen në arsimin e mesëm të lënda e Qytetarisë. Ndoshta edhe këtu është vendi që në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, të thellohen.

Faleminderit!

Petrit Vasili - Faleminderit!

Lidhur me çështjet që dolën konkretisht, pasi zonja Rakacolli bëri një ekspozitë për to, por disa probleme janë fare konkrete dhe sigurisht, sindikata i ka evidentuar në terren, nuk i ka evidentuar nga larg.

Këtu kemi përfaqësues nga Inspektorati i Punës. Cili është qëndrimi që mbahet, kur pothuajse në të gjitha ndërmarrjet (siç thuhet në material), mungojnë kartelat e shëndetit të punonjësve? Po jua them përsëri me shumë dashamirësi, por po jua them edhe si profesionist: çdo hap që thoni se bëhet për shëndetin në punë, nuk është asgjë, kur s'ka evidentimin e shëndetit të punonjësit. Kur një punonjësi nuk i evidentohen problemet, kur nuk fotografohet nga ana e shëndetit se çfarë problemesh shëndetësore ka, nuk mund të bëhet ndjekja e shëndetit të tij në punë. Kësaj i thonë të gënjejnë veten kolektivisht. Nuk ka mundësi, nuk ka një libër shkencor në botë pa të.

Ju them se Mjekësia e Punës ka një rregull. Ajo është një mjekësi që nuk bëhet me një libër. Kështu mund të bëhen Kardiologjia dhe Neurologjia, ndërsa Mjekësia e Punës është mjekësi me shumë libra. Një mjek profesional duhet të njohë mirë se cili është spektri i kimikateve, efektet e shtuara, sinergjike dhe efektet, të cilat potencohen. Ajo është një shkencë më vete, ku kalkullohet si potencohen efektet në shëndet. Pa pasur këtë fotografi, të gjitha rregulloret janë kot, megjithëse nuk dua të jem ofensiv. Nuk ka. Jashtë këtij rregulli dhe nuk del asnjë.

Që të masësh se si zhvillohet një *pneumoconiose* te shumë të sëmurë, punonjës të minierave, të cilët i shoqëron kjo sëmundje, nuk e bën dot po nuk e fotografove me atë që gjete, sepse nuk ndan dot se cili është efekti i punës dhe se cila është një sëmundje kronike bashkëshoqëruese, pra nuk e bën dot punën.

Në qoftë se është një fakt i tillë na thoni si e ndiqni, si e zgjidhni dhe si e impononi të zgjidhet! Të mos kesh kartela të shëndetit në punë në një ndërmarrje?! Ndërmarrjet tona nuk

janë si Metalurgjiku, ku janë me mijëra punonjës. Ne i dimë sa të mëdha janë ndërmarrjet. Kjo do të thotë mos t'u imponohesh atyre që ta bëjnë këtë.

Ju kontrolloni nëse janë paguar apo nuk janë paguar sigurimet atje dhe të tjera me radhë. Po ja, punonjësi i pagoi sigurimet, por nuk është ndjekur shëndeti i tij në punë. Mirë, shteti i mori sigurimet dhe është në rregull, po shëndeti i punonjësit ku shkoi? Bashkë me pagesën e sigurimeve duket të ketë këtë shërbim bazë, se për punën që bëjnë marrin lekët se derdhin djersën. Ku jemi dhe si e garantojmë jetën e tyre? Ai mund të jetë në një ndërmarrje abuzimeve, ku përdoren lloj-lloj kimikatesh. Shumë nga ata punonjës dihet se çfarë kualitetesh kanë dhe se çfarë janë. Kjo pyetje e do një përgjigje. Nuk po them një përgjigje për ne, por një përgjigje për të krijuar një ndjeshmëri që t'ju ndihmojmë dhe të ngremë zërin së bashku, të insistojmë që kjo të ndodhë.

Janë me mijëra njerëz që ekspozohen ndaj këtyre rreziqeve. Të gjitha kategoritë që referohen në material janë mbi 80% në punë të vështira, duke filluar nga minierat, te të gjitha llojet e fasonerive, te të gjitha veprimtaritë e mëdha të karakterit ekonomik dhe te shërbimet e zakonshme, kanë rrezikshmëri të ndryshme, por hyjnë te profesionet e vështira me ekspozim okupacional shumë të lartë dhe me pasoja të mëdha. Diku ndikon ana polmonare, diku është efekti i zhurmave, si maten ato etj.

Kolegu Luka nga ISHP-ja e di se dikur, para vitit 1990, janë ndjekur në kushte teknologjike shumë më të vështira sesa sot.

Për ekspozimin ndaj zhurmave, mund të ketë të gjithë faktorët në rregull dhe vetëm zhurma mund të jetë një shkaktar shumë i rëndë për sëmundje profesionale. Na thoni të paktën si do të zgjidhen këto probleme për sindikatat që e kanë ngritur problemin, jo për ne. Të gjithë së bashku duhet t'u japim një zgjidhje këtyre problemeve. Të paktën ta dimë se çfarë të ardhmeje do të ketë dhe kur do të zgjidhen.

Mira Rakacolli – Është përcaktuar formati i kartelave me të gjitha kërkesat. Është përcaktuar edhe lista e sëmundjeve profesionale. Për këtë të fundit është vendosur që sëmundjet profesionale duhet të deklarohen. Po bëhet në kuadër të bërjes së regjistrave të sëmundshmërisë kombëtare, sepse ka pasur gjithmonë probleme se kush do t'i bëjë këto lista. Ky proces fillon në shtator. Është futur edhe bërja e regjistratit për sëmundjet profesionale. Kartelat, formati i tyre është bërë. Mjekët e ndërmarrjeve, duhet ta plotësojnë atë. Një pjesë të kontrollit e kemi bërë ne dhe mua më rezulton që janë marrë vetëm 3 masa administrative në 2 muajt e fundit për mosplotësimin siç duhet të kërkesave.

Meqenëse janë këta të Inspektoratit të Punës këtu, nuk e di se cilat janë të dhënat që ka ky inspektorat në drejtim të plotësimit të kësaj karte.

Petrit Vasili – Faleminderit, zonja Rakacolli!

Fjalën e ka zonja Spiropali!

Elisa Spiropali – Faleminderit!

Falënderoj të gjithë përfaqësuesit e pranishëm për prezantimin e tyre dhe për ngritjen e këtyre shqetësimeve për të cilat ne jemi të gjithë të vetëdijshëm, se ka nevojë të punojmë më shumë!

Po hyj direkt në temë, meqenëse ne njihemi dhe raportet i kemi lexuar, zonja Rakacolli.

Ju thatë që në këta 6 muaj janë bërë 108 inspektime, ndërkohë janë dhënë vetëm 3 masa administrative. Këtë e shpjeguat (apo të paktën nga ajo që nënkuptova unë), se situata e punës apo gjendjes së shëndetit të punëtorëve apo e sigurisë së tyre, është pak a shumë e rregulluar përderisa janë dhënë vetëm 3 masa administrative. A jeni të sigurt se janë dhënë vetëm kaq masa vetëm për shkak të faktit se situata e këtyre vendeve të punës është e sigurt, apo ka arsye të tjera?

Për shembull një arsye është se inspektorët mund të bien dakord me punëdhënësit, apo ka arsye të tjera të fshehura për të cilat ministria duhet të ketë të paktën një kontroll dhe një qasje më të drejtpërdrejtë.

A jeni ju të sigurt se këto inspektorate e kryejnë punën dhe detyrën e tyre? A janë ato funksionale? Ndoshta për këtë mund të na ndihmojnë edhe përfaqësuesit e Konfederatës së Sindikatave të Shqipërisë apo përfaqësuesit e tjerë, sepse numri i masave administrative për punëdhënësit, më duket një numër shumë i ulët, në një kohë kur ne e dimë se situata e punës jo vetëm këtu, por edhe në vendet e tjera, me praktika të konsoliduara, ku ligji i punës respektohet deri në fund, ka vend për përmirësim, apo ka një numër shumë më të lartë masash administrative që merren edhe për punëdhënësit shumë të ndërgjegjshëm. Ne jemi të ndërgjegjshëm se ky është një vend, që raportin me punën dhe me punëmarrësin nuk e ka pasur fort të drejtë, kështu që më duket një numër i ulur masash administrative. Ndoshta duhet parë edhe mënyra se si inspektorët bëjnë kontrollet e tyre.

Petrit Vasili – Fjalën e ka kërkuar zonja Malaj.

Urdhëroni!

Nora Malaj – Duke falënderuar për ekspozenë që bënë të gjitha grupet e interesit dhe duke kuptuar edhe ndjeshmërinë e problematikës, dua të qartësoj, të sqaroj dhe njëkohësisht të bëj tri pyetje:

1. Nga sindikata na u tha se aktet nënligjore nuk janë të plota. Zonja Rakacolli na thotë se aktet nënligjore janë të plota. A janë të plota dhe, nëse janë të plota, a janë ngritur mekanizmat që ta kemi shumë të qartësuar këtë problematikë?

2. Para një jave në Durrës ka ndodhur një rast, ku rreth 20 zonja patën një helmim dhe ende sot nuk kemi marrë raport të mirëfilltë se cila është situata, çfarë ka ndodhur, me objektet dhe me institucionet përkatëse. Pyetja konkrete është: Sipas institucioneve, nga Inspektorati, te Ministria e Shëndetësisë dhe te sindikatat, cila është realisht situata dhe çfarë masash janë marrë? Nëse ky rast është tipik, çfarë mund të nxirret si rezultat edhe për fasoneritë e tjera të merren masa parandaluese për situatën aktuale?

3. Instituti i Shëndetit Publik në objektivat dhe politikat e tij ka qëllim të bëjë vit për vit studime apo raporte për shëndetin e punës. Cilat janë rezultatet aktuale, çfarë ka paraqitur dhe çfarë mund të paraqesë ISHP-ja, në mënyrë që të dy ministritë të bëjnë politika të dedikuara dhe sindikatat të jenë pjesë reale e aktivizimit të tyre?

4. Inspektorati për të realizuar pritshmërinë dhe për të rritur nivelin në mënyrë që kontrolli të jetë në interes dhe në parandalim të çdo shtate, çfarë plan-programi ka për kualifikimin e vazhdueshëm të punonjësve të saj? Cilat janë metodikat që përdor? Cilat janë rezultatet dhe mundësisht një kalendar, që edhe komisioni të ketë mundësi ta shohë herë pas here në kuadër të zbatueshmërisë së ligjit për të ndihmuar dhe për të sensibilizuar edhe aktorët që marrin pjesë në interesin e standardit dhe të cilësisë së punës?

Faleminderit!

Petrit Vasili – Faleminderit, zonja Malaj!

Fjala për ju zonja Rakacolli!

Mira Rakacolli - Faleminderit!

Në lidhje me pyetjen e parë për aktet nënligjore, unë fola për ato akte, të cilat ligji ia detyron Ministrisë së Shëndetësisë dhe ato që kanë të bëjnë me këtë ministri janë të plotësuar.

Ndërkohë që po flisnit, ka vetëm një, ky që po punohet tani me Ministrinë e Transporteve, që ka të bëjë me mjetet e lundrimit (kujdesi shëndetësor për mjetet e lundrimit), kurse të gjitha të tjerat, që i detyron ligji, Ministria e Shëndetësisë, e them me përgjegjësi, i ka plotësuar.

Për sa i përket ngjarjes së Durrësit, unë kam këtu një raport të plotë të ngjarjes. Analizat që iu bënë atyre grave, të cilat u shtruan në spital, fatmirësisht tregojnë se nuk ka absolutisht asnjë lloj mbetjeje toksikologjike në gjak. Janë marrë analiza nga ambienti përreth, që akoma nuk kanë dalë rezultatet në Institutin e Shëndetit Publik, njëkohësisht janë marrë edhe nga Drejtoria e Policisë Vendore në Durrës, janë marrë edhe mostrat nga veshjet, sepse është një fasoneri që bën veshje ushtarake, nga gjërat që ishin atje, nga objektet që ndodheshin aty dhe sipas raportit zyrtar që kemi, duan nga 30-60 ditë që të dalin rezultatet e analizave.

Analizat e gjakut nuk kanë treguar mbetje toksikologjike në gjak.

Petrit Vasili – Zonja Rakacolli, kam një plotësim për ju, s'ka lidhje me ju, por me çështjen.

Analizat e gjakut në 90% të rasteve nuk tregojnë asgjë në raste të tilla. Analizën e efektit të potencuar të disa shkaktarëve nuk e bën dot as Policia e Shtetit, por duhet ta bëjë ISHP-ja.

Cilat janë potencialisht kimikatet dhe si veprojnë veç e veç? Si mund të veprojnë në ambiente ku ato ndodhin njëherazi? Si ndodhin në kohë ekspozimi të caktuar? Si veprojnë ato në temperatura të caktuara? Kjo është një punë, e cila kërkon tjetër zanat dhe nuk është punë thjesht e policisë. Policia mund të marrë ca analiza dhe të thotë se të gjitha këto kimikatet janë të njohura, kanë ardhur sipas rregullave të caktuara, por të gjitha këto të kombinuara japin atë efekt sinergjik që në mjekësinë e punës, kush merret me këtë zanat, se nuk mund të bëjë zanatin policia, se nuk mund të zëvendësojmë zanatet e njeri-tjetrit... Ju jeni neurologe me shumë eksperiencë, por nuk e bën dot as kardiologu punën tuaj, kështu që edhe ky është një zanat i ndarë shumë mirë dhe në rastin konkret, një sugjerim miqësor, u thoni ta studiojnë me kriteret analitike shkencore, jo me kriteret policore, në qoftë se duam t'i shpëtojmë ato gra, pasi ka një indeks nga ana epidemiologjike, një event i ndodhur në ambientet e punës, që u takon më shumë se 20-30 personave, ka një shkak profesional. Këtë s'e kam thënë unë, por e kanë thënë 1100 burra të mençur që kanë shkruar traktate. Kjo është për të mirën e atyre njerëzve, jo për hatër të debatit që bëjmë sot.

Mira Rakacolli – Kjo është e drejtë. Unë e thashë pak më parë, po ndoshta fola shpejt dhe nuk u dëgjua mirë, se para se të thosha për policinë, thashë që janë marrë analizat nga ISHP-ja në ambientet ku ka ndodhur ngjarja dhe akoma nuk kanë dalë rezultatet përfundimtare për ndotjen ose jo...

Petrit Vasili - Edhe një sugjerim tjetër, meqë unë thashë ta shterojmë këtë gjë, të mos e vazhdojmë: i thoni ISHP-së, jo të bëjë analizat, por të bëjë studimin e plotë të dinamikës së punës. Nuk zgjidhet me analiza, ajo do një punë disajavore për të mos u përsëritur, sepse ripërsëritja në një shkallë të lartë mund të japë edhe probleme anafilaktike që mund të ikë njeriu kur të dojë. Këtë e kam për të mirë, se një event i dytë nuk do të jetë kaq miqësor sa ky i pari.

Ky është shkëmbim teknik idesh.

Mira Rakacolli – Derisa i është ngarkuar detyra ISHP-së për ta diskutuar fenomenin, është e qartë.

Të vazhdojmë me pyetjen e zonjës Spiropali në lidhje me numrin e paktë të masave.

Përderisa ne kemi një institucion të besueshëm, natyrisht edhe neve na ka rënë në sy ky numër i paktë dhe kemi diskutuar me drejtuesit, por përderisa nuk kemi edhe një informacion

tjetër nga të tjerë që i shikojnë, siç është Inspektorati i Punës, mua më duket që duhet ta besojmë, por natyrisht që ka vend që ta shohim.

Përveç Inspektoratit Shëndetësor kontrollon edhe Inspektorati i Punës, pra mund të ketë një raport nga Inspektorati i Punës dhe atëherë do të ishte shumë mirë që ne t'i shikonim këto gjëra, por natyrisht nëse kjo është në vazhdimësi që ka pak masa ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ne kemi këtu dy përfaqësues nga ISHP-ja, nëse ju interesoheni për gjëra më të hollësishme, ata mund t'ju përgjigjen fare mirë.

Për momentin ISHP-ja po e sheh problemin e shëndetit në punë jo thjesht në konceptin e të qenit ambient i pastër, por edhe në konceptin e mirëqenies sociale ose stresit në punë. Aktualisht tani është duke bërë një studim se si influencon stresi në punë në shëndetin e njerëzve, pra e shikon në konceptin më modern të shëndetit në punë se sa thjesht të punuarit në një ambient të shëndetshëm pa elemente toksike. Ndërkohë, ISHP-ja ka bërë disa studime për higjienën në punë. Në qoftë se ju i doni më me saktësi, i kemi këtu edhe nëndrejtorin e Shëndetit Publik, edhe përgjegjësin e sektorit dhe mund t'ua japim fjalën atyre.

Petrit Vasili – Faleminderit!

Zonja Bode.

Edlira Bode – Faleminderit, kryetar!

Doktoreshë Mira, e kisha në vazhdim të pyetjes që bëri zonja Spiropali. Prandaj desha të ndërhyja menjëherë, sepse lidheshin me njëra-tjetrën. Ka të bëjë me kontrollet, që ju thoni se keni bërë dhe keni gjetur shumë pak parregullsi, përderisa edhe masat administrative janë shumë të pakta. Unë kam punuar, për shkak të profesionit; para dy-tre vjetësh kam bërë edhe një studim mbi të gjitha fasoneritë e Devollit e të Korçës, në lidhje me ndotjen akustike, duke bërë matjen e dëgjimit të punonjësve. Rezultatet kanë qenë jo të mira, katastrofike.

Meqenëse po flasim për kartelat, përtej rezultateve, patjetër që një inspektor i Inspektoriatit Shëndetësor Shtetëror, që shkon aty dhe kërkon të kontrollojë nëse ka apo jo kartela, kartelat e punonjësve në rrobaqepësitë e Korçës e të Devollit ishin. Po, ishte kartela, me emër e mbiemër, me datën e fillimit të punës, e asnjë të dhënë tjetër. Në qoftë se një inspektor shkon dhe kontrollon kartelat dhe thotë se kartelat janë, nuk merr asnjë masë administrative, ndërkohë që ajo është një letër formale, pa asnjë përmbajtje.

Është mirë që këto ekipet e inspektorëve të kenë në përbërje profesionistët e duhur, që të mund të bëjnë kontroll ashtu siç duhet, jo të kontrollojnë vetëm nëse ka apo jo formalisht një letër, një kartelë.

Vijmë tani te çështja tjetër: gjatë fjalës suaj, ju thatë se keni ndërhyrë fort që në kurrikulat e specializimeve të ndryshme, të cilat tani, për fat të mirë, po funksionojnë, sepse ishin të bllokuara deri para tre vitesh; tani që janë duke u zhvilluar në disa nga specialitetet afatgjata, është futur edhe kurrikula për sëmundjet profesionale. Ndërkohë, nuk kemi atë që thamë, atë që ka bërë doktor Vasili, në lidhje me mjekun specialist për sëmundjet profesionale, po për mjekësinë e punës, çështje që i takon universitetit, që është i pavarur.

Si i bëhet, në qoftë se kjo punë nuk zgjidhet me diskutimet midis Ministrisë së Shëndetësisë dhe universitetit, që ne të kemi specialitetin e mjekësisë së punës. Na sugjeroni se çfarë mund të bëjmë, si mund të ndikojmë ne, që Universiteti i Mjekësisë të hapë degën, të plotësojë kurrikulën, me qëllim që të kemi sa më shpejt specialistë për mjekësinë e punës.

Faleminderit!

Petrit Vasili – Zonja Rakacolli.

Mira Rakacolli – Me shqetësimin që ju ngrini në lidhje me këtë, me sa kuptoj, ne duhet të shohim më mirë cilësinë e këtyre kontrolleve. Jo më kot i rreshtova të gjitha pikat, që atyre u është kërkuar të kontrollohen dhe të çekohen, dhe ato janë të gjitha të çekuara, por ndoshta ne duhet ta shohim një çikë më me vëmendje cilësinë. Faleminderit për sugjerimin!

Në lidhje me problemin e kurrikulës, natyrisht që ministria jonë ka biseduar me Ministrinë e Arsimit, dhe kurrikula do pak kohë. Pikërisht, për të fituar kohë në lidhje me bërjen e një kurrikule të plotë, është bërë kjo zgjidhja e ndërmjetme e futjes së këtyre programeve, të cilat lidhen me sëmundjet profesionale dhe shëndetin në punë në ato specialitete citova, por dhe të tjera, siç është për shembull pneumologjia, meqenëse ka të bëjë me sëmundje që shkaktohen nga këto.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, edhe neurologjia, sepse dihet se ka të bëjë me problemet e trurit e të nervave periferike. Pra, deri sa të arrijmë te kurrikula e plotë, kjo është zgjidhje e ndërmjetme, jo zgjidhje përfundimtare.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Problemi i burimeve njerëzore është problemi më i vështirë që duhet zgjidhur. Problemi që krijua është se edhe ata që do të përgatisin kurrikulat... aktualisht është punuar në lidhje me mjekësinë që ka të bëjë me sëmundjet profesionale. Në QSUT ka një lloj binjakëzimi me një organizatë italiane. Domethënë, janë ata që po punojnë. Ndërkohë, edhe Ministria e Shëndetësisë, nëpërmjet programeve të TAIEX-it, ka marrë specialistë vjet, të cilët e kanë parë këtë punë. E kemi diskutuar edhe me njerëzit, që janë përgjegjës në strukturat arsimore të Fakultetit të Mjekësisë, se si të mund t'i bëjmë më mirë këto gjëra. Është një punë që po ecën,

por gjithsesi, problemet e kurrikulare mbeten gjithnjë probleme të ngadalshme, të cilat vijnë një çikë edhe nga mungesa e njerëzve profesionistë të kësaj fushe; siç tha edhe kryetari, ka qenë një traditë e mirë, e cila u prish, ndërsa tani po përpiqemi ta ngremë prapë, për ta çuar atje ku e kërkojnë nivelet e zhvillimit në Bashkimin Europian, ku ne aspirojmë të shkojmë.

Petrit Vasili – Zoti Pendavinji. Me mikrofon, ju lutem! Faleminderit!

Ilir Pendavinji – Faleminderit, zoti kryetar!

Në fakt, fjalën time dua ta nis me falënderimin e zotërinjve Kol Nikollaj dhe Sami Kariqi, të cilët na bënë një ekspozitë shumë të qartë të prezencës së keqe të inspektorateve tona në lidhje me sigurinë në punë. Edhe kjo seancë, e cila flet për sigurinë në punë dhe zbatueshmërinë e këtij ligji, vërtetë do të na sensibilizojë, shpresoj edhe ministrinë përkatëse. Mua më erdhi keq që fillimi i fjalës së zotit Kol Nikollaj ishte se me shpërbërjen e Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale, niveli i kontrollit dhe i zbatueshmërisë së këtij ligji ka rënë në nivele të frikshme. Unë besoj se ky perceptim që ju keni, e që unë besoj se është i vërtetë, duhet të na sensibilizojë.

Përveç sigurisë së shëndetit, gjë me të cilën u mor zonja zëvendësministre, që nisi të na shpjegojë edhe pjesën e inspektimeve që janë bërë në terren, por edhe masat që janë marrë, unë do të doja të pyesja: sa inspektime ka bërë Inspektoriati Shtetëror i Punës? Vërtetë që ai është një inspektoriat që është dhe besoj se duhet të jetë gjithë ditën në terren, po përveç të gjitha pikave të tjera të kontrollit duhet të ketë edhe zbatueshmërinë e këtij ligji në pjesën e kontrolleve që bëjnë rëndom. Sa kontrole janë bërë nga Inspektoriati i Punës në lidhje me pjesën e zbatimit të këtij ligji të sigurisë në punë? Sa masa janë marrë? Cilat janë detyrat që mund të jenë lënë, sepse ligji e përcakton... Ne nuk vuajmë në aspektin e krijimit të ligjeve. Në qoftë se vuan, Shqipëria vuan nga zbatueshmëria e këtij ligji. Pjesa e inspektorateve është pjesa ku ne kemi marrë kamxhikun, të cilin shteti e ka vënë për të ndjekur zbatueshmërinë e këtij ligji, për t'u vënë sanksioneve punëdhënësve, që ata të zbatojnë kontratat me punëmarrësit, si dhe për të zbatuar të gjitha pikat, që ky ligj i përshkruan më së miri. Mbase Ministria e Ekonomisë duhet të punojë akoma më shumë, për të nxjerrë aktet e tjera nënligjore, që siç konstatoi zoti Nikollaj, janë bërë gjashtë para 2013-ës, dhe pesë janë bërë vetëm në kohën kur ishte Erion Veliaj ministër. Më pas kjo punë ka rënë. Mbase s'është e vërtetë. Prandaj do të donim një trajtim pak më të gjerë për këtë pjesë.

Faleminderit!

Irida Qosja – Unë jam Irida Qosja. Drejtoj sektorin e Inspektimit të Marrëdhënieve të Punës, në Inspektoriatin e Punës.

Në vijim të diskutimit të kësaj tryeze, unë do të desha të flas në lidhje me çështjen e inspektoriatit në raport me aspektet që ngriti zonja Gjino.

Meqenëse është realisht çështje shumë sensibil, nëse flasim, flasim për perceptim. Aspekti i parë që ngriti është përfshirja e gjithë punëmarrësve, me qëllim që të kemi një rezultat për kushte pune të sigurta dhe të shëndetshme, meqenëse janë të integruara së bashku. Për këtë do të desha t'ju informoja se nga 2013-a Inspektoriati i Punës ka organizuar tryeza, ose më saktë ka futur si risi organizimin e tryezave, me përfaqësues të ngarkuar për çështje të sigurisë e të shëndetit në punë, duke e nxitur këtë proces, që edhe ato ndërmarrje që nuk e kanë, ta kuptojnë rëndësinë e personave për çështjet e sigurisë e të shëndetit në punë e ndërmarrje, si të bëhen plotësisht efektivë atje ku janë.

Nga parafolësit u tha se Inspektoriati i Punës ka një trupë prej rreth njëqind inspektorësh në terren. Krahësuar me numrin e subjekteve, sigurisht ë numri i inspektorëve nuk mund t'i plotësojë apo t'i prekë të gjitha subjektet në kohë reale, për të kuptuar e për të zgjidhur problematikat ë ato mbartin. Duke qenë se punësimi vetë në vetvete është dinamikë, pra zhvillohet me një dinamikë të caktuar. Sigurisht çështja e inspektimit bëhet sfidë më vete. Për inspektimin e punës, të dalësh dhe të flasësh për një rezultat të prekshëm në treg, flasim me një shifër konkrete. Shifrat tona kanë të bëjnë me ato inspektime në të cilat subjektet i janë nënshtruar inspektimit të punës. Në këtë këndvështrim është i domosdoshëm forcimi i rolit inspektues. Kjo pjesë është pjesë e objektivave të institucionit, i cili na ka shoqëruar ne. Aktualisht dhe besoj se ju jeni të gjithë në dijeni të gjithë inspektoratet janë në reformën e ristrukturimit, Inspektorati i Punës është një prej tyre. Besojmë se çështja që ai do të zgjidhë më mirë do të jetë bashkëpunimi mes tyre. Duke qenë se këtu u përmend rasti i helmimit në fasonin e Durrësit del më në pah ky bashkëpunim, pasi Inspektorati Shëndetësor është eksperti kryesor për matjen e niveleve nëse kemi agjentë në ajër, nëse ka ndikuar diçka në helmimin e këtyre punonjësve. Ndërkohë që Inspektorati i Punës është aty për t'i përkthyer në masa konkrete ato gjetje që bën Inspektorati Shëndetësor për të mos ndodhur në të ardhmen situata të tilla. Çështja e Inspektoratit të Punës aktualisht është e hapur në kompaninë ku ndodhi ky helmim. Jemi brenda afateve ligjore që na përcakton ligji “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”. Inspektorët po punojnë të gjithë në portalin *e – inspection*. Të gjitha inspektimet janë në kohë reale *online* dhe kuptohet fare mirë se ku janë dhe çfarë po bëjnë. A ka nevojë për rritje profesionale? Sigurisht që po! A kemi nevojë për mbështetje? Patjetër, Inspektorati i Punës ka nevojë emergjente për një fuqizim të tij, qoftë edhe në kapacitetet e tij qoftë në numrin e inspektorëve, si edhe në logjistikë. Sot shumë gjëra i ka bërë shumë mirë me metodologjinë që po përdor dhe me mënyrën sesi po i mbikëqyr inspektorët që janë në terren,

po identifikon qartësisht se ku çalon puna dhe ku duhet të ndërhyhet. Për këtë, në vijim të asaj që u ngrit në këtë tryezë, besoj se është një çështje për të cilën ka shumë pak vend për diskutim, që lidhet me ndërgjegjësimin e të gjithëve për të adresuar problematika, me qëllim që edhe inspektimi të shkojë atje ku është i nevojshëm. Inspektorati i Punës, po të hyni në *website*-in e tij, në faqen zyrtare e ka në ndërtim. Besoj se brenda pak javësh do të hapet për të gjithë, pasi është konceptuar jo më si një faqe, e cila pasqyron punën e inspektorëve, por më tepër si një faqe informuese, ku çdo vizitor i faqes të ketë mundësi të marrë informacionin e duhur për të gjitha të drejtat që i jepen me ligj. Legjislacioni i punës përfshin një numër të madh ligjesh. Sigurisht, gjatë një inspektimi nuk mund të ezaurohen të gjitha çështjet, vendosen disa prioritete. Besoj se me pjesën e marrjes së informacionit bëhet një kanalizim më i mirë i gjësë. Ndërkohë që me ardhjen e drejtuesit të ri në këtë institucion, përmes një grupi pune po identifikon dy probleme.

E para, se cilat janë çështje që nuk janë plotësisht të mbuluara nga ligji dhe kanë nevojë për adresimin e tyre. E dyta, çështja e bashkëpunimit është shumë e rëndësishme për të kuptuar pse çalon diçka, pasi secili prej nesh nëse do ta shohë vetëm në këndvështrimin personal të institucionit që përfaqëson një çështje të caktuar, sigurisht ajo çështje asnjëherë nuk do të ezaurohet e gjitha, por duhen të bashkëpunojnë disa faktorë që.

Ajo që do të doja të përmendja është edhe metodologjia e vendosjes së dënimeve. Është e vërtetë ajo që sanksionet që vendosin inspektorët e punës në terren duhet të reflektojnë edhe situatën e shkeljes së dispozitave ligjore. Nëse inspektimi adresohet saktë atje ku është i nevojshëm, ky numër sanksionesh do të jetë në proporcion të saktë me numrin e subjekteve, nëse këto subjekte nuk do të bëhen sipas një planifikimi si duhet, ky numër nuk do të reflektojë atë që është e nevojshme. Në këtë kontekst ne po bëjmë një metodologji për vendosjen e dënimeve me qëllim vendosjen e një standardi që subjektet për të njëjtën shkelje të marrin të njëjtin sanksion dhe të mos i lihet inspektorit gjykim që të përcaktojë dënimet sipas asaj që gjën.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ja t’ju shpjegoj. Ligji “Për inspektimet në Republikën e Shqipërisë” ka diktuar një qasje dhe një metodologji krejt tjetër për ligjin “Për inspektimin e punës” pasi ai është ligji rregullator, i cili na ka përcaktuar dokumentacionin standard dhe sigurisht që ai kërkon një punë të caktuar për t’u implementuar. Flas për të marrë *feedback*- un personi i fundit që është në terren, nuk po flas për atë që është bërë. Pra, pavarësisht se ka filluar puna me dokumentacionin standard të inspektimit, po punohet, po jep fryte, (na ka dhënë risi në përdorimin e masave urgjente, që është një dënim, pavarësisht se nuk përkthehet në gjobë

monetare, i vihet një pezullim i pjesshëm një kompanie, ky është një dënim) e shikojmë me vend ndërhyrjen për të vendosur standardin në metodologji dhe këtë po e bën vetë Inspektorati i Punës.

Në tremujorin e parë të vitit 2018 kemi bërë 1560 inspektime, duke qenë se muajin e parë kemi qenë të angazhuar me Drejtorinë e Tatim-Taksave në kuadër të informalitetit dhe janë 30 subjekte të sanksionuara.

Petrit Vasili - Në rregull!

Faleminderit, zonja Qosja!

Që ta thjeshtojmë pak, se diskutimi i fundit, me thënë të drejtën ishte një diskutim shumë i mirë ministror, por nuk është diskutim terreni.

Do t'ju themi dy gjëra jo si mjekë, por si inspektorë, sepse e kemi bërë edhe punën e inspektorit për disa vjet, e di edhe Kola, e di edhe Samiu.

Zonjë, inspektimi është më i thjeshtë se sa kaq. Ai do tematikë të caktuar, do evidentimin e industrisë përkatëse. Cilat janë dëmet shëndetësore, në radhë të parë, sepse për këtë jemi sot këtu? Nuk jemi për sigurimet shoqërore të papaguara, pasi nuk është kjo tema e sotme. Në fund të ditës, të jeni të bindur, për fat të keq e them këtë gjë, në një kohë që kishim nga një stilolaps dhe disa kartela shumë të dobëta nga pikëpamja vizuale, nuk i kishim këta kompjuterët, se po të shkoni në Institutin e Shëndetit Publik do të gjeni në pëllëmbën e dorës jo ndërmarrjet këtu në qytet, por edhe galeritë më të thella të minierës, ku inspektorët nuk mund ta bënin nga sipërfaqja, por duhet të zbrisnin deri në furnelat e minierës, unë që po jua them jam futur në furnelë me *draker* në dorë për të dhënë të kuptohet sesa dëmtohet një punëtor i caktuar dhe si duhet të mbrohet. Si bëhet ndryshe? Kur riparohen anijet, duhet të futesh edhe atje në dopio fundet e anijes me *draker* që t'i matësh. Për këtë gjë nuk ka nevojë as për 10 mijë formularë, as për 10 mijë formalitete, por do vullnet dhe të ndiqet në mënyrë sistematike që ky inspektim të çohet në fund. Ky është arti i inspektimit dhe pasja e situatës në dorë. Gjëja e parë është kjo. Nga ana praktike unë dua të di: kush e ka regjistrin që ka të gjithë mjekët që shërbejnë si të tillë në qendrat e punës dhe të prodhimit? Pra, të themi: ky është regjistri i ndërmarrjeve dhe në krah këtu është Petriti, ky është Iliri, ky është tjetri e kështu me radhë. Pse jua them këtë gjë? Ka një periudhë transitore, është fare e qartë, ka të tjera ekzigjenca për të formuar në mënyrë universitare një mjek të mirëfilltë, i cili do të ndjekë problematikën e sëmundjeve profesionale, do të jetë mjek i punës. Ndërkohë ka edhe një mori të madhe të mjekëve që do të ndjekin sëmundjet dhe problematikën. Çfarë ndodh? Si zhvillohet? Duke pasur një regjistër kombëtar organizohet trajnimi shumë i shpejtë afatshkurtër i tyre në mënyrë që ata kur të shkojnë të mos kenë një kartelë “damlla”, siç tha zonja Bode, por të dinë që nga

ana kriteriale, minimumi këtë set të dhënash do t'i marrë, edhe nëse nuk i kujton, do të ketë një udhëzues, do të ketë shpenzuar edhe pak javë formim, të paktën të dhënat bazike nuk do t'i humbasin. Edhe kur të vijë më pas një specialist, ai ka të dhënat themelore, të cilat evidentojnë se ku ndodhet ky njeri që hyri. Kjo kërkon emergjencë, sepse sado që ata të formohen në specializimet pasuniversitare, gjithsesi numri do të jetë i kufizuar. Çfarë do të jenë ata? Ata do të jenë bërthama që do ta imponojnë këtë standard për të tjerët. Ky është themeli, sepse kështu kanë kaluar periudhat e tranzicionit dhe kjo është në mënyrë reale dhe praktike.

Çfarë kemi ne? Ka shumë mjekë që nuk kanë pasur eksperiencë të caktuara, por u trajnuan për të njohur problematikat e planifikimit familjar, apo problematikat e moshës së tretë, për aq sa u takonte kompetencave të tyre pa qenë ekspertë. Ama për ta vjelë problematikën bazë dhe plot problematika të tjera, të gjithë mjekët e shërbimit parësor janë trajnuar për të kuptuar dhe për trajtuar elementet shëndetësore të dhunës me të cilat përballeshin çdo ditë. Kjo punë duhet bërë dhe ne nuk mund të rrimë dot të presim se duhen përgatitur 7 apo 10 specialistë dhe në këtë mënyrë zgjidhet problemi. Jo! Ata duhet të vazhdojnë të mbajnë freskinë e kësaj ushtrie njerëzish, sepse industritë janë plot. Kemi mjekë, të cilët nuk shkojnë në punë me kohë të plotë, që e përkthyer thjesht do të thotë që minimumi duhet të rrinë 4 orë në punë, por shkojnë gjysmë ore, pinë një kafe dhe ikin. Kjo nuk është mjekësi.

Po ju them diçka konkrete. Kjo është emergjencë jo vetëm për dëmtimin e sa e sa punonjësve, por nga pikëpamja shëndetësore është një ngarkesë shumë e madhe edhe shëndetësore, edhe financiare për sistemin shëndetësor shqiptar. Sa më shumë të mos ndiqen të sëmurët, ata do të vijnë gjithmonë në një gjendje më të transkuruar dhe do t'i kushtojnë sistemit shëndetësor më shumë sesa i kanë kushtuar, prandaj kjo problematikë nuk është si të tjerat.

Mund të mos ndiqet mirë një i sëmurë kronik, kardiak apo me çfarëdo sëmundje tjetër, por jo një grup i madh prej 250 punonjësish që punojnë në një fasoneri, ku vetëm invalidizimi, për shkak të një operacioni mekanik që bëjnë, krijon dëm të dhjetëra njerëz. A e dini se sa i kushton kjo sistemit për ta trajtuar? Ndërkohë që me 2-3 instruksione të thjeshta për mënyrën e organizimit të kohës së punës e të pushimit, që janë elementet minimale bazike të ekonomisë, mund të shpëtohen shumë njerëz dhe mund të bëjnë një jetë shumë të mirë nga pikëpamja shëndetësore, por edhe sistemit do t'i kushtojnë shumë, sepse do të detyrohet t'i trajtojë dhe nuk mund t'u thotë: nuk të qas në spital ty.

Po marr një shembull tjetër: një problematikë fillestare kardiale, apo një problematikë fillestare neurotike nuk e përballojnë dot, sepse fasoneritë janë me mijëra dhe janë tejllozëm

në themelin e punës së tyre. E kanë bërë këtë punë dhe e kanë rënduar. Ky është shqetësimi që ne kemi.

Duhet të ikim nga këta formularët e bukur, të zbresim nga ai *inspection* dhe të shkojmë te *real inspection*. Kjo i duhet Shqipërisë, por patjetër që duhet edhe potencimi i Institutit të Shëndetit Publik për imponimin e standardeve dhe për imponimin e kurrikulave bazike, flas për ato më të domosdoshmet për të marrë informacion. Pra, edhe po të duam të marrim informacion, nuk do të arrijmë të marrim dot gjë, sepse po nuk u prodhua informacion, nuk ke se çfarë të mbledhësh. Për këshillat e punës, që kanë të bëjmë me përbërjen dhe organizimin e Këshillit të Sigurisë, me shëndetin në punë dhe përfaqësuesit e punëmarrësve, thuhet me të drejtë se janë formale, ose shumica e tyre nuk ekzistojnë.

Logjika mbi të cilën është ndërtuar ligji janë instrumentet, të cilat sigurojnë, që, duke qenë të gjitha palët, këto shërbime të garantohen, pasi mosngritja e tyre është një mundësi abuzimi, në radhë të parë, dhe, mbi të gjitha, e punëdhënësve, të cilët duan sa më pak kontroll, sa më pak shpenzime dhe sa më pak investim për këtë gjë. Prandaj krijohen të gjitha këto që të ketë një mekanizëm, dhe këtë ia referon sindikatës, ia referon shtetit nga të gjitha anët. Sa më shumë të mos ngrihen këto instrumente, aq më shumë nuk do të funksionojë sistemi, as në mënyrë piramidale, as në bazë dhe as në gjerësi. Atëherë çfarë ndodh? Të jeni të bindur që do të ndodhë ajo që bota e njeh si dukurinë e epidemisë së sëmundjeve profesionale, pra, një shpërthim i tyre me të gjithë larminë, por sistemi spitalor shqiptar nuk është kaq i fuqishëm dhe i pasur për ta përballuar këtë. Me shumë vështirësi mund të përballohet problematika e sëmundshmërisë normale e popullatës, por jo kjo sëmundshmëri e shtuar, prandaj e gjithë bota i qëndron te koka kontrollit të sigurisë së shëndetit në punë, sepse do të kursejë, por, në radhë të parë dhe, mbi të gjitha, është cilësia e jetës së njerëzve, si dhe kostot e mëdha me të cilat ngarkohen shërbimet shëndetësore. Kjo është problematika, prandaj shqetësohuni fort ju sikundër edhe ne, sepse të gjithë shqiptarët paguajnë një faturë që nuk e mbajnë dot dhe në këtë mënyrë do t'i futemi në pjesë njëri-tjetrit, pasi një shërbim spitalor, që nuk e përballon dot fluksin, nuk do të japë një shërbim të mirë çfarëdo të jemi ne, pasi sistemi hyn në tension kur nuk ka mundësi ta përballojë. Për këtë arsye e ngrita këtë shqetësim.

A ka ndonjë nga të ftuarit ndonjë gjë tjetër për të shtuar, pasi i dëgjoi këto fjalë?

Sami Kariqi – Unë kisha diçka për aspektin e marrëdhënieve të partnerëve socialë me Inspektoratin e Punës. Inspektorati është një institucion shtetëror, i cili ka përgjegjësi për zbatimin e ligjeve të punës. Ne jemi partnerë socialë, prandaj e mbështesim dhe e ndihmojmë Inspektoratin me informacione të ndërmjetme dypalëshe, trepalëshe e të tjera, por kjo realizohet në kuadrin e tripartitizmit, prandaj mendoj se ka një ngërç të vogël. Në ligjin për

Inspektoratin e Punës thuhet: “Marrëdhëniet me partnerët socialë rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave”, por që kur është bërë ligji për Inspektoratin e Punës nuk kanë dalë ose unë nuk i kam ndeshur dhe këta mund të na sqarojnë më mirë.

Pra, duhet një këshill trepalësh inspektorat-sindikatë-punëdhënës dhe në qoftë se nuk krijohet ky këshill, raportet do të jenë të shkëputura. Kaq kisha.

Petrit Vasili – Faleminderit, për ndërhyrjen tuaj!

A e dëshiron ndonjë tjetër fjalën?

Po.

Frosina Gjino – Unë kisha një pyetje për Inspektoratin e Punës. Ashtu siç u diskutua gjatë për mjekët e punës, i njëjti problem është edhe për ekspertët e sigurisë dhe të shëndetit në punë, të cilët nuk ekzistojnë fare, as si koncept. Po të shkoni në qendrën Kombëtare të Licencimit ata nuk e njohin si profesion. Kështu që në këtë gamë ligjore, a keni ndonjë mundësi që ta plotësoni? Si do të bëhet kjo gjë?

Ky është problemi më i madh, sepse si mund të zhvillohet një sistem kur nuk ka ekspertë, kur nuk përgatiten askund dhe kur nuk trajnohen?

Petrit Vasili – Qartë!

Sami Kariqi - Në kuadër të kësaj pyetjeje, a mund të shtoj diçka lidhur me mjekun e ndërmarrjes?

Petrit Vasili – Patjetër!

Sami Kariqi - Në vendimin e qeverisë thuhet se një ndërmarrje duhet të ketë 700 punonjës. Ne në Shqipëri nuk kemi ndërmarrje kaq të mëdha, ku një mjek të punojë në mënyrë definitive. Pra, që një mjek të mos punojë *part time*, por në mënyrë definitive, ndërmarrja duhet të ketë mbi 700 e sipër punonjës. Ky është një numër, që nuk mund të realizohet në ndërmarrjet tona. Ne e dimë që ndërmarrjet tona janë të shkatërruara dhe shumë pak ndërmarrje e kanë mundësinë të arrijnë të kenë 700 dhe më tepër punëtorë.

Së dyti, në këtë kuadër, punonjësit që bëjnë punë të vështira dhe të rrezikshme, siç janë: punonjësit e nëntokës, punonjësit e metalurgjikut, punonjësit që punojnë me kimikate e të tjerë, pra profesionet e kategorisë së parë, që ju i dini shumë mirë, sepse jeni mjek, zoti kryetar, ne mendojmë që në këto ndërmarrje duhet patjetër të jetë një mjek definitiv, ose të paktën të përcaktohen grupet, jo të futen të gjithë në një grup.

Petrit Vasili – Pra, ju po thoni që të kategorizohen si të tillë.

Sami Kariqi - Kam edhe diçka tjetër. Unë nuk e kuptoj që ne të shkojmë në një ndërmarrje dhe aty të mos gjejmë paketën e ndihmës së shpejtë.

Unë e them me bindje të plotë se asnjë ndërmarrje nuk ka as pambuk dhe as alkool. Pra, ka ndërmarrje që nuk e kanë kutinë e ndihmës së shpejtë, e cila kushton vetëm 15 mijë apo me 18 mijë lekë të vjetër.

Petrit Vasili – Atë që e ka çdo makinë me detyrim.

Sami Kariqi - Pra, e ka çdo makinë dhe nuk e kanë ndërmarrjet. Të mos flasim pastaj që nuk kanë një aparat tensioni, që është një gjë e vogël në dukje, por që kryen një funksion nëse një punonjësi i bie të fikët në punë.

Petrit Vasili – Sami, këtë gjë e kemi diskutuar edhe ne, por të flasim për gjërat reale.

Sami Kariqi - Këto janë gjëra shumë të vogla në dukje, të cilat ne po i kërkojmë me insistim. Madje u kemi thënë këtyre ndërmarrjeve që mund t’ua falim edhe ne një paketë të ndihmës së shpejtë.

Petrit Vasili – Këto ndërmarrje, për aq sa thatë ju, para se të kenë elektrokardiograf, e cila nuk u kushton asgjë, më parë duhet të kenë një aparat defibrylator, sepse mund t’u pushojë zemra kushedi sa punonjësve.

Në rast se dikujt i ndodh një goditje kardiake, patjetër që duhet paketa e ndihmës së shpejtë, se njerëz të gjallë jemi. Në kohën e sotme, me dinamikën që ka jeta sot, këto raste janë shtuar dhe 5 lekë më tepër që do të fitojë më shumë ndërmarrja, nëse nuk i blen këto aparate, nuk janë asgjë. Gjithashtu, mendoj se punëdhënësit nuk kanë presion, sepse në rast se do t’u bëhet një inspektim i fortë dhe të detyroheshin t’i blinin të gjitha aparaturat bashkë, nuk do t’u kushtonte asgjë, sepse çmimet e tyre janë qesharake.

Këtë gjë po t’i thosha edhe zonjës, se në pjesën kompjuterike jeni mirë, por në terren çfarë bëhet?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ndërmarrjet masive me 700 punëtorë është realiteti që ka përfunduar në Shqipëri dhe nuk mund të vijë dot më kurrë. Në Shqipëri nuk ka ndërmarrje masive me 700 punëtorë. Numërohen vetëm me gishtat e dorës dhe nëse janë 10, atëherë, janë shumë.

(Diskutime pa mikrofon)

Ka ndërmarrje me mbi 700 punonjës?!

(Diskutime pa mikrofon)

Ligji aq është, me 700 punonjës.

(Diskutime pa mikrofon)

Eda Beqiraj - Jo, për profesionet e vështira, prandaj është e ndarë me dy grupe “A” dhe “B”. Pra, grupet “A” dhe “B” janë mbi 700 punonjës e sipër, kurse për grupet “C” dhe “D” janë për çdo 1500 punëmarrës të ketë një mjek.

(Diskutime pa mikrofon)

Elisa Spiropali - Pra, ju folët vetëm statistikisht për raportime dhe gjoba që janë vënë, por duhet që raportimi të jetë cilësor. A i keni evidentuar ju këto sipërmarrje, të cilat kanë këtë numër punonjësish dhe çfarë kushtesh duhet të kenë? A i kanë apo jo kushtet? Gjithashtu, mendoj se duhet të ketë edhe një protokoll, se ndonjëherë ka edhe mungesë informacioni.

Eda Beqiraj - Jo, por 1460 subjekte janë të mbuluara me shërbimin mjekësor për vitin 2017.

Ky shërbim mjekësor është i ndarë me kohë të pjesshme, ndërsubjektor, që, faktikisht, edhe ky është një problem madhor, se mjeku ndërsubjektor për subjektet e grupeve që i kemi C dhe D, sidomos për grupin D, të cilat janë me nën 20 punëmarrës, ka shumë subjekte që drejtohen pranë nesh dhe thonë “Ku ta gjejmë ne këtë mjekun ndërsubjektor, kur nuk ka një listë të pasqyruar të mjekëve të punës?”. Për shembull, nëpër botë, siç kemi lexuar dhe siç kemi pasur bashkëpunime, kanë institute të mirëfillta me mjekë pune, pra subjektet private, ose shtetërore, në rastin e kërkesës për mjekë ndërmarrjeje, u drejtohen këtyre institucioneve dhe pajisen me mjekun ndërsubjektor.

Shërbimi i ndihmës së parë. Kemi 3256 subjekte për vitin 2017 në të cilat ekziston shërbimi i ndihmës së parë, kështu që ne kemi shifra, por problemi madhor është evidentimi i sëmundjeve profesionale dhe raportimi i tyre, sepse raportimi i sëmundjeve profesionale, sipas VKM-së përcaktuese, bëhet nga mjeku i ndërmarrjes në rastin e dyshimit dhe duhet ta dërgojë te mjeku specialist i sëmundjeve profesionale, që fatkeqësisht akoma nuk ekziston. Kjo sëmundje profesionale duhet të shoqërohet me fletëdeklarimin tip të sëmundjeve profesionale për përfitimin tek sigurimet shoqërore.

Ashtu sikurse aksidenti përfiton nga sigurimet shoqërore, edhe sëmundja profesionale duhet të përfitojë nga sigurimet shoqërore. Ndërkohë ne, si inspektorat raportojmë shifra të sëmundjeve profesionale, por i themi gjithmonë në raste të dyshuara jo të vërtetuara nga formulari tip dhe nga mjeku specialist i sëmundjeve profesionale.

Kjo është situata.

Petrit Vasili – Më falni, a t’ju them diçka përsëri, që të paktën të mbetet diçka e nënvijëzuar? Edhe në botën që referuat ju, edhe në botën shumë të pasur dhe me shumë njerëz, nuk ka aq mjekë të sëmundjeve profesionale sa do e gjithë popullsia.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më lini ta mbaroj arsyetimin! Kini pak durim!

Po pati diçka që nuk shkon në fjalët e mia, ma kundërshtoni!

Edhe në Shqipërinë e para viteve '90 ka pasur një grup të caktuar mjekësh dhe shumë mjekë të tjerë që punonin të trajnuar për këtë punë. Pra, patjetër që çdo sëmundje në këtë dynja do dyshim, se ju nuk jeni mjekë, kurse konfirmimi është momenti i fundit.

Këta trajnohen në mënyrë bazike, që të kenë aftësinë e dyshimit dhe verifikimi bëhet më pas. Por për këtë takëm mjekësh, të cilëve u kemi bërë tri formularë me 80 faqe, ku jepen grupet kryesore, elementet e dyshimit dhe ndërtimi i *arterjes*, duhet bërë kjo punë, sepse edhe sikur të formohen dhe të vijnë 10, 15 apo 20, pa e bërë këtë punë këta mjekë të bazës, apo ata që do të punojnë, nuk do të dinë të dyshojnë dhe te mjekët ekspertë nuk do të vijë lëndë e parë për t'u verifikuar.

E kuptoni çfarë po ju them? Pra, detyrimisht dy gjëra praktike dhe fare të thjeshta: evidentimi i të gjithë mjekëve ndërsbjektorë, që shërbejnë në qendra pune (më mirë thojeni shqip, mjekë që u shërbejnë disa ndërmarrjeve, se njerëzit nuk e kuptojnë dot). Përveç të tjerave, kemi gjithsej 1400, por shërbejnë 800 dhe nëse do të ofrosh shërbim në një ndërmarrje ku ata paguhen, (*është e detyruar që do vish, do ta bësh këtë gjë*) në fund do të kenë një letër ku do të thuhet: ky mjeku ka bërë kursin e përmbledhur dy-javor me këto e me ato elemente dhe bashkë me ato tri materialet i ka në tavolinën e punës, të cilat i merr e i lexon, sepse kjo është puna e çdo mjeku. Kjo punë duhet bërë me nxitim të madh dhe me shumë prioritet, është praktike, është e vërtetë dhe të jep elementet bazike për të kontrolluar situatën. Mjekët specialistë do të bëjnë rrugën e tyre dhe duan kohën e tyre për t'u formuar, se nuk formohen për një vit. Që të jenë specialistë iu duhen minimumi 3 vjet. Ndërkohë çfarë bëhet? Gjithë kjo mori e madhe pune që zhvillohet, me të gjithë larminë e vet, na bën të ngremë pyetjen: a do ta kemi situatën në dorë, apo jo, se mund të themi që i kontrolloam 5 mijë dhe nuk na doli asgjë? Si është situata konkrete? Ky është problemi. Për këtë e kemi të gjithë merakun, nuk e kemi për gjë tjetër.

A ka ndonjë nga të ftuarit që dëshiron të shtojë diçka?

Po, zoti Nikolla.

Kol Nikolla – E kam me dashamirësi. Duke shfrytëzuar rastin që jeni pjesë e pozitës këtu, në emër të Konfederatës, por mbase bie dakord edhe me kolegët e Bashkimit të Sindikatave të Pavarura, ne duhet t'i kërkojmë qeverisë që Këshilli Ndërmintor të vihet në funksion dhe sindikatat duhet të jenë pjesë e këtij këshilli, sepse besoj se shumë probleme ezaurohen atje. Pjesa më e madhe u fokusua të puna e mjekësisë, por këtu ka probleme të jashtëzakonshme dhe do të duheshin ditë të tëra t'i marrim me radhë.

Petrit Vasili – Faleminderit, zoti Nikolla!

Nëse nuk kemi gjë tjetër, i falënderoj shumë të gjithë të ftuarit! I gjithë materiali që do të prodhohet dhe do të përmblihet, do t'u dërgohet të ftuarve nga një kopje. Nëse do të keni ndonjë sugjerim të mëtejshëm, na e thoni që ta pasqyrojmë.

Faleminderit të gjithëve!

MBYLLET MBLEDHJA